

VENDIM
Nr.9, datë 7.1.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS KOLONJË, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kolonjë, të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Kolonjë, të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.164, datë 25.3.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kolonjë, të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kolonjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kolonjë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoret për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
98-106	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
112-117	Varreza publike	Në pronësi
171-179,184-192,194,195	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
118-168	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
202-209	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
302	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
14-26	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
40-97	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
180-183	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit. (toka	Në përdorim

	produktive)	
27-39, 219, 244, 251, 261, 276, 279, 287, 291	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit. (kanale të treta dhe toka joproductive)	Në pronësi